




KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**



Në bazë të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale lidhur me nenin 78 të Statutit të Komunës së Gjilanit, me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01nr.016-28448 të datës 22.03.2018, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të Lartë Administrativ, pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunësit civil Bashkim Nexhipi 02.Nr.016-101666 të datës 29.08.2022 për pezullimin vullnetar të marrëdhënies së punës, merr këtë:

**V E N D I M**  
**P Ë R**  
**PEZULLIMIN VULLNETAR TË MARRËDHËNIES SË PUNËS**

1. Aprovohet kërkesa e nëpunësit civil, Bashkim Nexhipi i emëruar në pozitën punuese: Zyrtar për kulturë në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe të njëjtit i Lejohet pezullimi vullnetar i marrëdhënies së punës pa kompenzim nga data 01.10.2022 deri më 15.12.2022.
2. Për kohën e mungesës nga puna pa kompenzim sipas pikës 1 të këtij vendimi, nëpunësi civil i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës.
3. Obligohet nëpunësi civil që në punë të parqitet me datën 16.12.2022.

**A r s y e t i m**

Nëpunësi civil Bashkim Nexhipi i emëruar në pozitën punuese: Zyrtar për kulturë në kuadër të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport i është drejtuar Drejtorit të Drejtorisë me kërkesën 02.Nr.016-101666 të datës 29.08.2022 me qëllim që i njëjti t'ia lejojë pezullimin vullnetar të marrëdhënies së punës për arsye familjare.

Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport si mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunësit civil rekomandon Organin më të lartë administrativ dhe punëdhënës-Kryetarin e Komunës që kërkesën e nëpunësit civil ta aprovojë sepse mungesa e tij në punë nuk do të reflektohet në procesin e punës së DKRS.

Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit më të lartë administrativ dhe punëdhënës pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunësit civil për pezullimin e vullnetar të marrëdhënies së punës pa pagesë dhe rekomandimin e Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport që kërkesa të

aprovohet, në bazë të Rregullores (QRK) nr.12/2020 për orarin dhe pushimet e zyrtarëve publik, vendosi si në dipsozitivin e këtij vendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në KPMSHCK në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimin të vendimit.

**Vendimi t'i dorëzohet:**

- Drejtorit të DKRS
- Nëpunësit civil
- NJBNI

